



Dokument Politikash

Çfarë duan të rinjtë për Bashkinë Kavajë?

Shkurt 2023

PARATHËNIE:

Demokracia Këtu | Demokracia Tani është një iniciativë e Këshillit të Evropës e koordinuar nga Departamenti i Rinisë dhe që synon rigjallërimin e demokracisë nëpërmjet forcimit të besimit të ndërsjellë midis të rinjve, institucioneve dhe proceseve demokratike¹.

Pjesëmarrja në jetën demokratike të çdo komuniteti është më shumë se votimi ose kandidimi në zgjedhje, megjithëse këto janë elementë të rëndësishëm të një shteti demokratik funksional. Anë e mbanë botës të rinjtë duket se bëjnë thirrje të vazhdueshme për ndryshim duke vendosur theksin tek të drejtat e njëriut, funksionimi i institucioneve, zbatimi i ligjit, diversiteti dhe hapsirat për pjesëmarrje. Megjithatë, ajo që vihet re është se rrugët tradicionale të pjesëmarrjes dhe përfshirjes së të rinjve nuk i përmbushin siç duhet nevojat e tyre.

Për këtë arsye, nevoja për të rivendosur theksin tek rivitalizimi i demokracisë duke vendosur në qendër të rinjtë dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimarrëse, u bë një shtysë e shoqatës **“Udhëtim i Lirë-Liberi di Viaggiare”** për të hartuar dhe konceptuar iniciativën **“Të Rinjtë për Demokracinë Lokale”** e cila është implementuar në kuadër të fushatës **Demokracia tani | Demokracia këtu** me suportin e **Fondacionit Rinor European** dhe **Këshillit të Evropës**.

“Të Rinjtë për Demokracinë Lokale” targeton specifikisht të rinjtë e Bashkisë Kavajë me synim fuqizimin e të rinjve për ushtrimin e të drejtave të tyre dhe rritjen e vëmendjes së bashkisë Kavajë kundrejtë çështjet rinore. Aktualisht, **“Ligji për Rininë”**², një ligj i ri i miratuar për herë të parë në Shqipëri, heq disa nga barrierat ligjore dhe krijon hapësirë për të krijuar mekanizma të dedikuar për pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal, duke përfshirë programe të dedikuara rinore, struktura dhe buxhet të dedikuar, duke lejuar kështu grupet e interesit që merren me të rinjtë, jo vetëm që të kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e këtyre komponentëve, por edhe të ushtrojnë presion mbi institucionet qeveritare mbi përgjegjësitë që ato kane për rininë, si dhe të përfshihen në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit dhe monitorimit.

Ky dokument politikash është bashkë-hartuar dhe konceptuar nga të rinjtë pjesëmarrës në iniciativën **“Të Rinjtë për Demokracinë Lokale”**, ku pjesë e aktiviteteve dhe takimeve të

¹ https://www.coe.int/en/web/democracy-here-now/home?pk_campaign=newsletter

² <http://rinia.gov.al/ligji-per-rinine/>

zhvilluara në kuadër të këtij projekti kanë qenë jo vetëm të rinjtë e gjimnazeve dhe të rinjtë e qytetit të Kavajës por edhe anëtarë të Këshillit vendor pranë bashkisë Kavajë. Ky dokument ka lindur si nevojë e të rinjve për të parashtruar problematikat dhe rekomandimet e tyre përballë institucioneve lokale dhe aktorëve aktiv ne komunitetin e tyre.

E drejta e autorit:

© Ky dokument politikash është hartuar nga shoqata **“Udhëtim i Lirë”-Liberi di Viaggiare** në kuadër të projektit **“Të Rinjtë për Demokracinë Lokale”** i cili mbështetet nga **Fondacioni Rinor European** me suportin e **Këshillit të Evropës** në kuadër të fushatës **“Demokracia këtu/Demokracia tani”**. Ky dokument paraqet pikëpamjet e autorëve dhe aktorëve të përfshirë gjatë metodologjisë së hartimit të këtij dokumenti dhe nuk paraqet kurrësesi pikëpamjet e Fondacionit Rinor European apo Këshillit të Evropës. Ripërsëritja apo riprodhimi i këtij materiali nuk mund të bëhet pa miratimin me shkrim nga autorët dhe shoqata **“Udhëtim i Lirë”-Liberi di Viaggiare**.



TABELA E PËRMBAJTJES:

PARATHËNIE:	2
HYRJE	5
I. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË KËTIJ DOKUMENTI	7
II. ANALIZA E SITUATËS SË TË RINJVE NË BASHKINË KAVAJË	8
III. PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT E TË RINJVE NË BASHKINË KAVAJË	9
IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	11

HYRJE

Me sfidat dhe emigrimin masiv që Shqipëria po përballet sidomos vitet e fundit, duket se rinia është kthyer në kryefjalën e çdo politike dhe ndërhyrjeje strategjike që implementohet qoftë nga aktorët institucional, qoftë nga aktorë të tjerë siç janë organizatat e shoqërisë civile, komuniteti i biznesit, përfaqësues të akademisë etj. Mundësitë e limituara për punësim dhe arsim cilësor, besim i ulët tek institucionet, klima politike dhe dëshira për një stabilitet socio-ekonomik duket se renditen si barrierat kryesore që të rinjtë hasin për të investuar dhe qëndruar në vendin e tyre.

Megjithëate, sektori rinor në Shqipëri që pas aprovimit të ligjit **75/2019 “Për Rininë** duket se ka hyrë në një tjetër fazë zhvillimi ku përpos institucioneve të reja që janë themeluar si rrjedhojë e tij, një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish janë parashikuar edhe për institucionet në nivel lokal.

Bazuar në Nenin 7 të këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me funksionet e tyre, hartojnë dhe zbatojnë politikat vendore në fushën e rinisë, si dhe janë përgjegjëse për:

- pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të të rinjve, duke përcaktuar objektivat dhe prioritetet, si dhe të garantojnë zbatimin e tyre;
- krijimin e këshillit vendor të rinisë;
- organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që synojnë arritjen e objektivave vendore në fushën e mbrojtjes dhe të fuqizimit të të rinjve;
- organizimin dhe ofrimin e veprimtarive për të mbështetur mirëqenien dhe zhvillimin e të rinjve;
- nxitjen e vullnetarizmit të të rinjve dhe edukimin joformal të tyre;
- dh) financimin e krijimit dhe të zhvillimit të infrastrukturës rinore dhe të hapësirave rinore të sigurta;
- krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë;
- ë) parashikimin, në buxhetet e tyre, të fondeve për realizimin progresiv të të drejtave të të rinjve për zhvillimin e projekteve, programeve dhe veprimtarive rinore;
- mbledhjen, analizimin dhe raportimin e të dhënave, në bashkëpunim me institucionet e tjera, për situatën e të drejtave të të rinjve në territorin e tyre.

Gjithashtu, ky nen parashtron faktin se “Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të aplikojnë për t’u mbështetur nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare për rininë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në fuqi”³.

Edhe pse ky ligj është miratuar që në vitin 2019, duket se implementimi i tij ka vijuar me hapa të ngadaltë sidmos në institucionet lokale, ku edhe pas tre viteve nga implementimi i Ligjit për Rininë, duket se situata për të rinjtë në shumë bashki mbetet e pandryshuar.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm në sektorin rinor është hartimi dhe miratimi i **“Strategjisë së Rinisë 2022-2029”**⁴. Ky dokument i cili u miratuar në Dhjetor 2022 përmban 3 prioritetet strategjike:

QËLLIMI I PARË POLITIK I STRATEGJISË

Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t’u shprehur me zërin e tyre. Politikatat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financiar.

QËLLIMI I DYTË POLITIK I STRATEGJISË

Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar kështu mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

QËLLIMI I TRETË POLITIK I STRATEGJISË

Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rinjve. siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social.

Ky dokument në fakt është hartuar për herë të parë në Shqipëri, pasi më herët ka ekzistuar vetëm një Plan Veprimi për Rininë i cili është implementuar brenda periudhës 2015-2022. Ky dokument shërben si një udhërrëfyes i politikave rinore në nivel kombëtar, duke vënë theksin tek ndërhyrjet strategjike për të zgjidhur problematikat që të rinjtë hasin në vend. Megjithatë është shumë e rëndësishme që ky dokument të përkthehet dhe të përshtatet edhe në nivel lokal, pasi kontekstet në bashki të ndryshme paraqesin prioritetet të ndryshme lidhur me komunitetin rinor që është prezent për zonën që ato mbulojnë.

³ <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Permbledhje-e-ligjit-dhe-akteve-n%C3%ABnligjore-n%C3%AB-fush%C3%ABn-e-rinis%C3%AB.pdf>

⁴ https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_500_I.%20Strategjia%20Kombetare%20e%20Rinise%202022.pdf

I. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË KËTIJ DOKUMENTI

Ky dokument është hartuar në kuadër të iniciativës “Të Rinjtë për Demokracinë Lokale” i cili implementohet nga “Shoqata Udhëtim i Lire-Liberi di Viaggiare” me suportin e Fondacionir Rinor European dhe Këshillit të Evropës.

Metodologjia për hartimin e këtij dokumenti përfshin rishikimin e literaturës ekzistuese dhe zhvillimin e 3 fokus grupeve të dedikuara me të rinjtë pjesëmarrës të iniciativës. Me suportin e ekspertëve të rinjtë kanë bashkë-hartuar këtë dokument, i cili synon të adresojë problematikat e tyre përpara politikëbërësve duke bërë një analizë të situatës aktuale dhe duke identifikuar prioritetet e tyre.

Ajo që vihet re gjatë monitorimit, identifikimit dhe analizës së dokumentave, raporteve apo dokumentave ekzistues, është një mungesë e theksuar e të dhënave qoftë cilësore apo sasiore lidhur me të rinjtë në Bashkinë Kavajë, duke limituar kështu jo vetëm analizimin e tyre por edhe transparencën ndaj të rinjve dhe publikut nga ana e institucioneve.

Megjithatë, nga monitorimi në terrën dhe fokus grupet e dedikuara, 20 të rinjtë pjesëmarrës kanë pasuruar gjetjet dhe rekomandimet e këtij dokumenti, i cili do të shërbejë si bazë për lobimin dhe advokimin e mëtejshëm të tyre ndaj Bashkisë Kavajë.

II. ANALIZA E SITUATËS SË TË RINJVE NË BASHKINË KAVAJË

Bashkia e Kavajës, sipas Censurit të vitit 2011 së bashku me të gjitha njësitë e saj administrative, numëron një popullsi prej 40,094 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 79,445 banorë. Me sipërfaqe prej 198.81 km², ajo ka densitet prej 201 banorë/km² sipas censurit dhe 400 banorë/km² sipas regjistrimit civil. Edhe pse të rinjtë përbëjnë rreth 27% të popullsisë ende Bashkia Kavajë nuk disponon një dokument strategjik dedikuar të rinjve për të zgjidhur problematikat që ata hasin në komunitetet ku jetojnë apo bëjnë pjesë.

Deri më tani tani Kavaja ka një **“Strategji sociale”** që është publikuar në vitin 2018 e cila parashikon krijimin e një qendre sociale që ofron shërbime për të rinjtë dhe viktimat e abuzimit social, drogave dhe krimeve por fatkeqësisht zbatimi i tij ka mbetur vetëm në letër. Në këtë situatë ku shoqëria civile është thujse inekzistente dhe ku autoritetet vendore nuk disponojnë kapacitete e duhura institucionale, ligjore, ekonomike dhe njerëzore për të mbështetur të rinjtë dhe fuqizimin e tyre, shumica e të rinjtë vendosin të migrojnë nga vendi.

Përfshirja aktive, e informuar dhe vullnetare e qytetarëve në vendim- marrje është e një rëndësie të veçantë në ndërtimin e një shoqërie demokratike. Problematikat ekonomike, sociale, apatia, mosbesimi, mundësitë e pakta të edukimit dhe aftësisimit për të drejtat dhe përgjegjësitë ka krijuar një nivel të ulët të pjesëmarrjes së të rinjve duke reflektuar në një demokraci të brishtë. Duke qenë se pjesëmarrja e të rinjve paraqet gur themelin për arritjen e qeverisjes së mirë, është e nevojshme që të krijohet një mjedis i sigurtë për aftësimin dhe përfshirjen e të rinjve në Bashkinë e Kavajës për të adresuar problematikat prioritare në komunitet e tyre dhe të krijohet një kulture aktive qytetare në proceset vendim-marrëse.

III. PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT E TË RINJVE NË BASHKINË KAVAJË

Problematikat kryesore që të rinjtë kanë evidentuar gjatë fokus grupeve të zhvilluara janë përmbledhur si më poshtë:

- **Demokrati e brishtë dhe nivel i ulët i transparençës:** Të dhënat për Rininë në Bashkinë e Kavajës janë shumë të pakta të aksesueshme nga ata vetë dhe nga aktorët që punojnë me rininë. Ky fakt, ndikon drejtëpërdrejtë në cilësinë dhe mundësinë e tyre për të ushtruar të drejtat e tyre demokratike si dhe për të mbajtur institucionet publike nën monitorim lidhur me implementimin e buxhetit apo programeve/iniciativave që diskutohen, parashikohen dhe implementohen në emër të të rinjve të Kavajës.
- **Mungesë e programeve që targetojnë fuqizimin e të rinjve:** Ajo që vihet re nga analiza e programeve ekzistuese, Bashkia Kavajë nuk ka programe specifike të dedikuara për të rinjtë. Ajo që vihet re është se çdo program që synon edukimin, sportin apo kulturën cilësohet si program rinor duke qenë se indirekt të rinjtë cilësohen si përfitues të këtyre iniciativave. Fuqizimi i të rinjve është një tematikë e gjerë e cila mund të përkthehet në shumë sfera, por sërish vëmëndja ndaj të gjithë aktorëve është e vakët.
- **Koordinim dhe bashkëpunim i ulët midis aktorëve që punojnë në sektorin rinor:** Edhe pse iniciativat rinore janë të pakta, të rinjtë pjesëmarrës shprehen se aty ku ato ekzistojnë, koordinimi midis aktorëve të ndryshëm jo gjithnjë është i mundur dhe jo gjithnjë është efektiv. Edhe pse Bashkia Kavajë ka shprehur publikisht qasjen pozitive ndaj nismave rinore, sërish një pjesë e mirë e aktorëve të tjerë mbëten skeptik mbi kapacitetet dhe mundësitë që ato kanë për të suportuar dhe financuar nismat rinore.
- **Mungesa e një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës:** i cili adreson mungesën e kapaciteteve (njerëzore, materiale dhe financiare) për të siguruar aksesin ndaj të rinjve që i përkasin grupeve vulnerabël, minoriteteve apo të rinjve me aftësi ndryshe.

- **Nxitje dhe mbështetje e ulët ndaj punësimit dhe sipërmarrjes rinore:** Punësimi i të rinjve mbetet një nga problematikat kryesore që të rinjtë hasin në bashkinë Kavajë duke qenë se masivisht punësimi i të rinjve është sezonal dhe kushtët e punës nuk përmbushin pritshmëritë e tyre për një jetë të denjë dhe me prosperitet.
- **Mbështetje e ulët ndaj pjesëmarrjes aktive dhe përfaqësimi rinor në Bashkinë Kavajë:** Të rinjtë shprehen se përpara themelimit të Këshillit Rinor të Kavajës, pjesëmarrja dhe përfshirja e të rinjve në proceset dhe mekanizmat vendimarrëse ka qenë pothuaj inekzistente. Megjithatë sfida që ata kanë aktualisht, përveç ekzistencës së tyre është edhe mirëfeksionimi i kësaj strukture me kapacitetet dhe cilësinë e duhur, për të përfaqësuar bashkëmoshatarët e tyre në mënyrë të denjë.
- **Jetë socio-kulturore e vakët:** Arti, sporti, kultura dhe mjedisi janë disa nga tematikat të cilat të rinjtë kanë evidentuar si mungesë në Bashkinë Kavajë. Ata shprehen se jeta socio-kulturore dhe hapsirat recreative ku të rinjtë mund të kalojnë kohën, të zhvillohen, të argëtohen dhe të kalojnë kohë më njëri-tjetrin janë të pakta në qytetin e tyre.
- **Mbështetja e ulët ndaj organizatave dhe nismave rinore:** Të rinjtë pjesëmarrës shprehin nevojën për të pasur një shoqëri civile më prezentë dhe më të gjallëruar në komunitetin e tyre. Ata deklarojnë se nevojat aktuale që nuk mund të përmbushen nga bashkia si pasojë e mungesës së burimeve apo resurseve financiare, duhet deri diku të përmbushen nga organizatat rinore dhe për të rinjtë me qëllim fuqizimin dhe adresimin e sfidave që ata hasin në komunitet.
- **Shërbime publike, sociale dhe shëndetësore të vakta dhe të vështira për tu aksesuar nga të rinjtë:** Shumica e shërbimeve publike janë në qendër të qytetit, çka e bën të vështirë aksesin dhe marrjen e këtyre shërbimeve nga të gjithë të rinjtë. Ata gjithashtu shprehen se cilësia e këtyre shërbimeve nuk është gjithnjë në nivelin e duhur, që rrjedhimisht ndikon në cilësinë e jetesës së të rinjve të Kavajës.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Pjesëmarrja aktive jo vetëm e të rinjve por edhe e aktorëve të tjere dhe grupeve të interesit në shoqëri është shumë e rëndësishme për cilësinë dhe shëndetin e demokracisë së një vendi. Për këtë arsye, insitucionet publike si aktorët kryesorë në mbarvajtjen e demokracisë, duhet të sigurohen që të mundësojnë mekanizmat e duhur që nxisin jo vetëm përfshirjen e qytetarëve apo të rinjve, por edhe dialogun midis institucioneve dhe partnerëve social, si dhe impaktin e drejtëpërdrejtë të tyre në politikëpërbje dhe proceset vendimarrëse.

Si rezultat i iniciativës “Të Rinjtë për Demokracinë Lokale” 20 të rinjtë pjesëmarrës janë mbështetur dhe trajnuar në tema si: Edukimi qytetar, Lobimi, Advokimi, Pjesëmarrja, Aktivizmi, Demokracia Pjesëmarrëse, Të Drejtat dhe Detyrat Politike dhe Dialogu i Strukturuar; Fushata Avokuese, Komunikimi; Mjetet e aktivizmit në internet dhe Angazhimi në Komunitet.

Rekomandimet që vetëm të rinjtë kanë hartuar dhe shprehur gjatë aktiviteteve të kësaj iniciative janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

1- Hartimi dhe përditësimi i të dhënave cilësore dhe sasiore për të rinjtë me qëllim rritjen e transparencës së institucioneve publike dhe nxitjen e llogaridhënies tek qytetarët. Sipas tyre, mungesa e këtyre të dhënave ndikon drejtëpërdrejtë në hartimin e politikave, programeve apo ndërhyrjeve në sektorin rinor me synim investimin tek të rinjtë në menyrë cilësore dhe afat-gjatë.

2-Rritja e financimit dhe mbështetjet ndaj iniciativave rinore: Të rinjtë synojnë rritjen e financimit për të rinjtë, jo vetëm në zhvillimin e aktiviteteve për të rinjtë apo edhe mbështetjes së sipërmarrjes dhe aktivizmit rinor nëpërmjet granteve.

3-Hartimi i një Strategjie Lokale për të rinjtë e Bashkisë Kavajë: Koordinimi dhe sinergjia midis pushtetit qëndror e lokal janë shumë të rëndësishme për të pasur impakt dhe përfitime të ndërsjellta jo vetëm tek grupet e interesit por edhe tek të rinjtë

4- Fuqizimi dhe nxitja e dialogut të strukturuar midis Këshillit Lokal Rinor-Bashkië Kavajë dhe të Rinjve: Të rinjtë rekomandojnë zhvillimin e takimeve periodike midis përfaqësuesve të pushtetit lokal, të rinjve të KVR si dhe të rinjve të tjerë të qytetit në mënyrë që të nxisin bashkëveprimin por edhe ndërgjegjësimin e paleve mbi rëndësin e përfshirjes së të rinje në vendimarrje

5-Përmirësimin e Infrastrukturës Rinore në Bashkinë Kavajë: Mungesa e një hapsire dhe qëndre rinore në qytet, paraqitet si një ndër kërkesat kryesore të të rinjve ndaj Bashkisë Kavajë. Ata shprehen se mungesa e kësaj hapsire pengon edhe ata pak të rinj që janë aktiv në komunitet dhe duan të japin kontributin e tyre. Sipas tyre, ka kohë që ky projekt përflitet por konceptimi i tij mbetet vetëm në letër.

6-Rritja e Informimit Publik dhe Transparencës mbi çështjet rinore: Të rinjtë e Bashkisë Kavajë kërkojnë të jenë të informuar vazhdimisht mbi çështjet dhe zhvillimet rinore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Ata kërkojnë të hartohen mekanizma cilësor informimi që mundësojnë përditësimin e të rinjve në kohë si dhe rritjen e transparencës publike. Ata gjithashtu rekomandojnë përditësimin mbi iniciativat dhe buxhetin lokal, në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga të gjithë të rinjtë.